



SQ Enëlarëse

Udhëzimet për përdorim



PËRMBAJTJA

1. INFORMACIONI I SIGURISË.....	2
2. UDHËZIMET PËR SIGURINË.....	4
3. PËRSHKRIMI I PRODUKTIT.....	6
4. PANELI I KONTROLLIT.....	7
5. PROGRAMET.....	7
6. CILËSIMET.....	9
7. PËRPARA PËRDORIMIT TË PARË.....	13
8. PËRDORIMI I PËRDITSHËM.....	14
9. UDHËZIME DHE KËSHILLA.....	15
10. KUJDESI DHE PASTRIMI.....	17
11. ZGJIDHJA E PROBLEMEVE.....	20
12. TË DHËNA TEKNIKE.....	25

MENDOJMË PËR JU

Faleminderit që bletë një produkt Electrolux. Ju keni zgjedhur një produkt i cili sjell me vete dekada të tëra me përvojë dhe risi nga profesionistë. Ky produkt gjenial dhe elegant është projektuar duke ju pasur juve në mendje. Pra, sa herë që ta përdorni mund të ndiheni të sigurt do të merrni rezultate të shkëlqyera. Mirë se vini në Electrolux.

Vizitoni faqen tonë të internetit për:



Marrjen e këshillave të përdorimit, broshurave, informacionit për ndreqjen e problemeve, shërbimin dhe riparimin:

www.electrolux.com/support



Regjistrimin e produktit tuaj për shërbim më të mirë:

www.registerelectrolux.com



Blerjen e aksesorëve, pjesëve të konsumueshme dhe pjesëve origjinale të këmbimit për pajisjen tuaj:

www.electrolux.com/shop

KUJDESI DHE SHËRBIMI PËR KLIENTËT

Përdorni gjithmonë pjesë origjinale këmbimi.

Kur kontaktoni Qendrën tonë të Autorizuar të Shërbimit, sigurohuni që të dispononi të dhënat e mëposhtme: Modeli, PNC, numri serial.

Informacioni mund të gjendet në pllakën e specifikimeve.

⚠ Paralajmërim / Të dhëna për sigurinë dhe kujdesin

ⓘ Të dhëna të përgjithshme dhe këshilla

🏠 Të dhëna për ambientin

Rezervohet mundësia e ndryshimeve.

1. ⚠ INFORMACIONI I SIGURISË

Përpara instalimit dhe përdorimit të pajisjes, lexoni me kujdes udhëzimet e ofruara. Prodhuesi nuk është

përgjegjës për lëndimet apo dëmet si rezultat i instalimit apo përdorimit të papërshtatshëm. Gjithmonë mbajini udhëzimet në një vend të sigurt dhe ku mund të arrihen lehtë për t'iu referuar në të ardhmen.

1.1 Siguria e fëmijëve dhe personave me probleme

- Kjo pajisje mund të përdoret nga fëmijë të moshës 8 vjeç e sipër dhe persona me aftësi të kufizuara fizike, ndijimesh ose mendore ose që nuk kanë eksperiencë dhe njohuri, nëse këta mbahen nën mbikëqyrje ose udhëzohen për përdorimin e sigurt të pajisjes dhe i kuptojnë rreziqet e përdorimit.
- Fëmijët nga 3 deri në 8 vjeç dhe personat me aftësi të kufizuara shumë të theksuara dhe komplekse duhet të mbahen larg nga pajisja, përveçse kur mbahen nën monitorim të vazhdueshëm.
- Fëmijët nën 3 vjeç duhet të mbahen larg nga pajisja, përveçse kur mbikëqyren në mënyrë të vazhdueshme.
- Mos lejoni fëmijët të luajnë me pajisjen.
- Mbajini detergjentet larg fëmijëve.
- Mbajini fëmijët dhe kafshët shtëpiake larg pajisjes, gjatë kohës që dera e saj është e hapur.
- Fëmijët nuk duhet të kryejnë pastrimin dhe mirëmbajtjen e pajisjes pa mbikëqyrje.

1.2 Siguria e përgjithshme

- Kjo pajisje është vetëm për përdorim në shtëpi dhe për përdorime të ngjashme, si p.sh.:
 - në shtëpi në fshat, në zonat e kuzhinës për personelin në dyqane, në zyra dhe në ambiente të tjera pune;
 - nga klientët në hotele, motele, hotele me mëngjes dhe ambiente të tjera banimi.
- Mos i ndryshoni specifikimet e kësaj pajisjeje.
- Presioni i ujit në punë (minimal dhe maksimal) duhet të jetë mes 0.5 (0.05) / 8 (0.8) bar (MPa)
- Respektoni numrin maksimal të cilësimeve me 9 vende.

- Për të shmangur rreziqet, nëse kabllloja e furnizimit është e dëmtuar, ajo duhet zëvendësuar nga prodhuesi, qendra e autorizuar e shërbimit ose persona me kualifikim të ngjashëm.
- Vendosini takëmet në koshin e takëmeve me majat e mprehta me drejtim poshtë ose vendosini ato në sirtarin e takëmeve në pozicion horizontal me majat e mprehta poshtë.
- Mos e lini pajisjen me derën të hapur të pamonitoruar për të shmangur shkeljen aksidentale mbi të.
- Përpara se të kryeni shërbim mirëmbajtjeje, çaktivizoni pajisjen dhe hiqni spinën nga priza.
- Mos përdorni spërkatës me ujë me presion të lartë dhe/ose avull për të pastruar pajisjen.
- Nëse pajisja ka vrima ajrimi në pjesën e poshtme, ato duhet të mos bllokohen p.sh. nga tapeti.
- Pajisja duhet të lidhet me rrjetin e furnizimit me ujë duke përdorur pajisjet e dhëna të zorrëve. Kompletet e vjetra të tubave nuk duhet të ripërdoren.

2. UDHËZIMET PËR SIGURINË

2.1 Instalimi



PARALAJMËRIM!

Vetëm një person i kualifikuar duhet ta instalojë këtë pajisje.

- Hiqni të gjithë paketimin.
- Mos instaloni ose mos përdorni një pajisje të dëmtuar.
- Ndiqni udhëzimet e instalimit të dhëna me pajisjen.
- Gjithmonë bëni kujdes kur e lëvizni pajisjen sepse është e rëndë. Përdorni gjithnjë doreza sigurie dhe këpucë të mbyllura.
- Mos e montoni ose mos e përdorni pajisjen në vende me temperaturë nën 0°C.
- Instalojeni pajisjen në një vend të sigurt dhe të përshtatshëm që plotëson kërkesat e instalimit.

2.2 Lidhja elektrike



PARALAJMËRIM!

Rrezik zjarri dhe goditjeje elektrike.


- Pajisja duhet tokëzuar.
- Sigurohuni që parametrat në pllakën e specifikimeve të përkojnë me vlerat elektrike të rrjetit elektrik.
- Përdorni gjithmonë një prizë të tokëzuar të instaluar si duhet.
- Mos përdorni përshtatës me shumë spina dhe kablo zgjatuese.
- Sigurohuni që të mos dëmtoni prizën dhe kabllon elektrike. Nëse kabllloja elektrike duhet zëvendësuar, kjo duhet bërë nga Qendra jonë e autorizuar e shërbimit.
- Pajisjen futeni në prizë vetëm në fund të instalimit. Sigurohuni që spina të jetë e arritshme pas montimit të pajisjes.
- Mos e shkëputni pajisjen nga rrjeti duke e tërhequr nga kabllloja elektrike.

Gjithmonë tërhiqeni kabllon elektrike duke e kapur nga spina.

- Kjo pajisje është e pajisur me një spinë 13 A. Nëse ju duhet ta ndërroni siguresën e spinës, përdorni vetëm një siguresë 13 A ASTA (BS 1362) (vetëm Mbretëria e Bashkuar dhe Irlanda).

2.3 Lidhja e ujit

- Mos u shkaktoni dëmtim tubave të ujit.
- Përpara lidhjes me tuba të rinj, tubat që nuk janë përdorur për një kohë të gjatë, aty ku janë kryer punime riparimi ose janë vendosur pajisje të reja (sahate uji, etj.), lëreni ujin të rrjedhë derisa të jetë i kthjellët dhe i pastër.
- Sigurohuni që të mos ketë rrjedhje të dukshme uji gjatë dhe pas përdorimit të parë të pajisjes.
- Zorra e hyrjes së ujit ka një valvul sigurie dhe një veshje me kablo të brendshme.



PARALAJMËRIM!
Tension i rrezikshëm.

- Nëse zorra e hyrjes së ujit dëmtohet, mbyllni menjëherë rubinetin e ujit dhe shkëputni spinën nga priza elektrike. Kontaktoni me Qendrën e Autorizuar të Shërbimit për zëvendësimin e tubit të hyrjes së ujit.

2.4 Përdorimi

- Mos vendosni produkte të ndezshme ose sende të lagura me produkte të ndezshme brenda, pranë ose mbi pajisje.
- Detergjentet e lavastoviljeve janë të rrezikshme. Zbatoni udhëzimet e sigurisë në ambalazhin e detergjentit.

- Mos pini ujin në pajisje dhe mos luani me të.
- Mos i hiqni enët nga pajisja derisa të ketë përfunduar programi. Mbi enë mund të mbesë detergjent.
- Mos i ruani artikujt ose mos peshoni mbi derën e hapur të pajisjes.
- Pajisja mund të lëshojë avull të nxehtë kur hapni derën gjatë kohës që një program larjeje është në punë.

2.5 Ndriçimi i brendshëm



PARALAJMËRIM!
Rrezik plagosjeje.

- Në lidhje me llambat brenda produktit dhe llambat e pjesëve të këmbimit të shitura veçmas: Këto llamba janë prodhuar për kushte ekstreme fizike në pajisjet elektroshtëpiake, si p.sh. temperaturë, dridhje, lagështirë, ose janë prodhuar për të sinjalizuar informacion rreth statusit të përdorimit të pajisjes. Ato nuk janë prodhuar për t'u përdorur në aplikacione të tjera dhe nuk janë të përshtatshme për ndriçim në ambiente shtëpiake.
- Për të zëvendësuar dritën e brendshme, lidhuni me qendrën e autorizuar të shërbimit.

2.6 Servisi

- Për të riparuar pajisjen kontaktoni me qendrën të autorizuar të shërbimit. Përdorni vetëm pjesë këmbimi origjinale.
- Ju lutemi vini re se vetëriparimi ose riparimi joprofesional mund të ketë pasoja sigurie dhe mund të zhvlerësojë garancinë.
- Pjesët e mëposhtme të këmbimit do të jenë të disponueshme për 7 vjet pas daljes nga qarkullimi të modelit: motori, pompa e qarkullimit dhe e shkarkimit, ngrohësit dhe elementet e ngrohjes, duke përfshirë pompat e nxehtësisë, tubacionet dhe pajisjet përkatëse duke përfshirë zorrët, valvulat, filtrat dhe bllokuesit e ujit, pjesët strukturore dhe të brendshme për grupet e derës, qarqet elektrike, ekranet elektronike, çelësat e presionit, termostatet dhe sensorët, softuerët dhe firmuerët duke përfshirë


softuerin e rivendosjes. Ju lutemi vini re se disa nga këto pjesë këmbimi janë të disponueshme vetëm për riparuesit profesionistë, dhe se jo të gjitha pjesët e këmbimit u përshtaten të gjitha modeleve.

- Pjesët e mëposhtme të këmbimit do të jenë të disponueshme për 10 vjet pas daljes nga qarkullimi të modelit: mentesha dhe guarnicionet e derës, guarnicionet e tjera, krahët spërkatës, filtrat e shkarkimit, raftet e brendshme dhe pajisjet plastike periferike si koshat dhe kapakët.

3. PËRSHKRIMI I PRODUKTIT



Grafika më poshtë paraqet vetëm pamjen e përgjithshme të produktit. Për informacion më të detajuar, referojuni kapitujve të tjerë dhe/ose dokumenteve që keni marrë me pajisjen.



- 1** Bangoja
- 2** Krahët e sipërm spërkatës
- 3** Krah u spërkatës i poshtëm
- 4** Filtrat
- 5** Pllakëza e specifikimeve

- 6** Kutia e kripës
- 7** Tubi i ajrit
- 8** Foleja e shkëlqyesit
- 9** Kutia e detergjentit
- 10** Koshi i takëmeve

2.7 Eliminimi i pajisjes




PARALAJMËRIMI!
Rrezik lëndimi ose mbytjeje.

- Shkëputeni pajisjen nga rrjeti i furnizimit elektrik.
- Prisni kabllon e lidhjes me rrjetin dhe hidheni atë.
- Hiqni kapësen e derës për të parandaluar bllokimin brenda pajisjes të fëmijëve dhe të kafshëve shtëpiake.

11 Koshi i poshtëm

12 Koshi i sipërm

4. PANELI I KONTROLLIT



1 Treguesi i ndezjes/fikjes

2 Shënuesi i programit

3 Treguesit

4 Butoni i shtyrjes së programit

5 Butoni Start


6 Çelësi i programeve

4.1 Treguesit

Treguesi	Përshkrimi
	Treguesi i fazës së tharjes. Është ndezur kur zgjidhni një program me fazën e tharjes. Pulson kur është në funksionim faza e tharjes.
	Treguesi i kripës. Ndizet kur kutia e kripës ka nevojë për rimbushje. Ky tregues është gjithmonë i fikur kur programi është në funksionim.
	Treguesi i shkëlqyesit. Ndizet kur kutia e shkëlqyesit ka nevojë për rimbushje. Ky tregues është gjithmonë i fikur kur programi është në funksionim.
	Treguesi i fazës së larjes. Ndizet kur është në funksionim faza e larjes.
	Treguesi i fazës së shpëlarjes. Ndizet kur është në funksionim faza e shpëlarjes.

5. PROGRAMET

Rendi i programeve në tabelë mund të mos reflektojë sekuencën e tyre në panelin e kontrollit.


Programi	Lloji i ngarkesës	Niveli i ndotjes	Fazat e programit
ECO 1)	<ul style="list-style-type: none"> Enë prej fajance Takëmet Tenxhere Tiganë 	<ul style="list-style-type: none"> Normal Pak e tharë 	<ul style="list-style-type: none"> Paralarja Larja 50 °C Shpëlarje çasti Shpëlarja përfundimtare 60 °C Tharja AirDry
160 min	<ul style="list-style-type: none"> Enë prej fajance Takëmet Tenxhere Tiganë 	<ul style="list-style-type: none"> Nga normale deri në të rëndë E tharë 	<ul style="list-style-type: none"> Paralarja Larja 60 °C Shpëlarje çasti Shpëlarja përfundimtare 60 °C Tharja AirDry
90 min	<ul style="list-style-type: none"> Enë prej fajance Takëmet Tenxhere Tiganë 	<ul style="list-style-type: none"> Normal E tharë e lehtë 	<ul style="list-style-type: none"> Larja 60 °C Shpëlarje çasti Shpëlarja përfundimtare 55 °C Tharja AirDry
30 min	<ul style="list-style-type: none"> Enë prej fajance Takëmet 	<ul style="list-style-type: none"> E sapobërë 	<ul style="list-style-type: none"> Larja 50 °C Shpëlarje çasti Shpëlarja përfundimtare 50 °C AirDry
Rinse hold  2)	<ul style="list-style-type: none"> Të gjitha llojet e ngarkesave 	<ul style="list-style-type: none"> Të gjitha shkallët e ndotjes 	<ul style="list-style-type: none"> Paralarja

1) Ky program ofron përdorimin më efikas të konsumit të ujit dhe të energjisë për enë dhe takëme me ndotje normale. Ky është programi standard për institutet e testimit. Ky program përdoret për të vlerësuar pajtueshmërinë me Rregulloren 2019/2022 të Komisionit (BE-së) për Ekodizajnin.

2) Me këtë program, mund të shpëllani lehtë ushqimet e mbetura nga enët dhe të parandaloni formimin e aromave në pajisje. Mos përdorni detergjent me këtë program.

5.1 Vlerat e konsumit

Programi 1) 2)	Uji (l)	Energjia (kWh)	Kohëzgjatja (min)
ECO	9.9 ³⁾ / 9.9 ⁴⁾	0.778 ³⁾ / 0.779 ⁴⁾	240 ³⁾ / 240 ⁴⁾
160 min	10.5 - 12.8	0.888 - 1.086	160
90 min	9.5 - 11.7	0.713 - 0.871	90
30 min	8.7 - 10.6	0.542 - 0.663	30

Programi 1) 2)	Uji (l)	Energjia (kWh)	Kohëzgjatja (min)
Rinse hold 	2.9 - 3.6	0.012 - 0.015	15

1) Presioni dhe temperatura e ujit, ndryshimet në furnizimin me energji elektrike, opsionet, sasia e enëve dhe shkalla e papastërtisë mund t'i ndryshojnë vlerat.

2) Vlerat për programe të tjera përveç ECO janë vetëm treguese.

3) Në përputhje me rregulloren 1016/2010.

4) Në përputhje me rregulloren 2019/2022.

5.2 Informacion për institutet e testimit

Për të marrë informacionin e nevojshëm për kryerjen e testeve (p.sh. sipas EN60436), dërgoni një email në adresën:

info.test@dishwasher-production.com

Në kërkesën tuaj ju lutemi përfshini kodin e numrit të produktit (PNC) që gjendet në pllakëzën e parametrave.

Për pyetje të tjera në lidhje me lavastoviljen tuaj, ju lutemi referojuni librit të shërbimit që keni marrë me pajisjen.

6. CILËSIMET

6.1 Regjimi i përzgjedhjes së programit dhe regjimi i përdoruesit

Kur pajisja është në regjimin e përzgjedhjes së programit, është e mundur të caktoni një program dhe të hyni te regjimi i përdoruesit.


Cilësimet e disponueshme në regjimin e përdoruesit:

- Niveli i zbutësit të ujit sipas fortësisë së ujit.
- Aktivizimi ose çaktivizimi i njoftimit të zbrazjes së shkëlqyesit.
- Niveli i shkëlqyesit sipas dozës së kërkuar.
- Aktivizimi ose çaktivizimi i AirDry.


Duke qenë se pajisja i ruan cilësimet e ruajtura, nuk është nevoja për ta konfiguruar përpara çdo cikli.

Si të caktoni modalitetin e përzgjedhjes së programit

Pajisja ndodhet në modalitetin e përzgjedhjes së programit kur treguesi i

ndejes/fikjes ndizet dhe treguesi  pulson.

Pas aktivizimit, pajisja ndodhet gjithmonë në modalitetin e zgjedhjes së programit. Nëse nuk është ashtu, vendosni modalitetin e zgjedhjes së programit sipas mënyrës së mëposhtme:

Shtypni dhe mbani shtypur  derisa pajisja të jetë në modalitetin e zgjedhjes së programit.

6.2 Zbutësi i ujit

Zbutësi i ujit heq mineralet nga uji, gjë që mund të ketë një efekt negativ në rezultatet e larjes dhe në pajisje.

Sa më e lartë të jetë përmbajtja e këtyre mineraleve, aq më i fortë është uji. Fortësia e ujit matet në shkallët ekuivalente.

Zbutësi i ujit duhet të rregullohet sipas fortësisë së ujit në zonën tuaj. Autoritetet përkatëse të ujësjellësit mund t'ju informojnë mbi fortësinë e ujit në zonën tuaj. Është e rëndësishme që të vendosni nivelin e duhur të zbutësit të ujit për të siguruar rezultate të mira në larje.

Fortësia e ujit

Gradë gjermane (°dH)	Gradë franceze (°fH)	mmol/l	Gradë Clarke	Niveli i zbutësit të ujit
47 - 50	84 - 90	8,4 - 9,0	58 - 63	10
43 - 46	76 - 83	7,6 - 8,3	53 - 57	9
37 - 42	65 - 75	6,5 - 7,5	46 - 52	8
29 - 36	51 - 64	5,1 - 6,4	36 - 45	7
23 - 28	40 - 50	4,0 - 5,0	28 - 35	6
19 - 22	33 - 39	3,3 - 3,9	23 - 27	5 1)
15 - 18	26 - 32	2,6 - 3,2	18 - 22	4
11 - 14	19 - 25	1,9 - 2,5	13 - 17	3
4 - 10	7 - 18	0,7 - 1,8	5 - 12	2
<4	<7	<0,7	< 5	1 2)

1) Cilësimi i paracaktuar në fabrikë.

2) Mos përdorni kripë në këtë nivel.

Pavarësisht llojit të detergjentit të përdorur, vendosni nivelin e duhur të fortësisë së ujit për të mbajtur aktiv treguesin e rimbushjes me kripë.



Tabletat e shumëfishta që përbajnë kripë nuk janë mjaft efikase për të zbutur ujin e fortë.

Procesi i rigjenerimit

Që zbutësi i ujit të funksionojë siç duhet, rezina e pajisjes së zbutësit duhet të rigjenerohet rregullisht. Ky proces është automatik dhe është pjesë e funksionimit normal të lavastoviljes.

Kur është përdorur sasia e përshkuar e ujit (shikoni vlerat në tabelë) që prej procesit të mëparshëm të rigjenerimit, do të fillojë një proces rigjenerimi mes shpëlarjes përfundimtare dhe përfundimit të programit.

Niveli i zbutësit të ujit	Sasia e ujit (l)
1	250
2	100

Niveli i zbutësit të ujit	Sasia e ujit (l)
3	62
4	47
5	25
6	17
7	10
8	5
9	3
10	3

Në rast se zbutësi i ujit është vendosur në një cilësim të lartë, mund të ndodhë edhe në mes të programit, përpara shpëlarjes (dy herë gjatë programit). Fillimi i rigjenerimit nuk ndikon në kohëzgjatjen e ciklit, përveçse kur ndodh në mes të programit ose në fund të një programi me fazë të shkurtër tharjeje. Në këto raste, rigjenerimi zgjat kohëzgjatjen totale të një programi me 5 minuta më shumë.

Si rrjedhojë, shpëlarja e zbutësit të ujit që zgjat 5 minuta mund të fillojë në të njëjtin cikël ose në fillim të programit të ardhshëm. Ky aktivitet rrit konsumin total të ujit të një programi me 4 litra më shumë dhe një konsum total energjie të programit me 2 Wh më shumë. Shpëlarja e zbutësit përfundon me shkarkimin e plotë.




Secila shpëlarje e zbutësit që kryhet (që mund të jetë më shumë se një brenda të njëjtit cikël) mund ta zgjasë kohëzgjatjen e programit me 5 minuta të tjera kur ndodh në ndonjë pikë tjetër në fillim ose në mes të një programi.


i Të gjitha vlerat e konsumit të përmendura në këtë paragraf janë përcaktuar në përputhje me standardin që aplikohet aktualisht në kushte laboratorit me fortësi uji 2,5 mmol/L sipas rregullores 2019/2022 (zbutësit të ujit: niveli 3). Presioni dhe temperatura e ujit si edhe variacionet e furnizimit me energji mund të ndryshojnë vlerat.



Caktimi i nivelit të zbutësit të ujit

Sigurohuni që pajisja të jetë në modalitetin e zgjedhjes së programit.

Sigurohuni që shënjesi i programit mbi buton të jetë në pozicionin ndezur/fikur.

1. Për të hyrë në modalitetin e përdoruesit, shtypni e mbani . Njëherësh rrotulloni butonin në drejtim të kundërt të akrepave të orës derisa shënjesi i programit të tregojë programin e parë. Lëshojeni  kur treguesit  dhe ndezur/fikur të pulsojnë.

Pulsimi me ndërprerje i  tregon cilësimin aktual, p.sh. 5 pulsime + pauzë + 5 pulsime = niveli 5.

2. Shtypni  vazhdimisht për të ndryshuar parametrin. Sa herë që shtypni  numri i nivelit rritet. Pasi arrin nivelin 10, numërimi do të fillojë sërish nga niveli 1.

3. Për të konfirmuar parametrin, rrotulloni butonin e programeve derisa shënjesi i programit të jetë sërish në pozicionin ndezur/fikur

6.3 Njoftimi i zbrazjes së kutisë së shpëlarësit

Shpëlarësi ndihmon në tharjen e enëve pa shenja dhe njolla. Ai lëshohet automatikisht gjatë fazës së shpëlarjes me ujë të nxehtë.




Kur kutia e shpëlarësit zbrazet, treguesi i shpëlarësit aktivizohet duke njoftuar për rimbushjen me shpëlarës. Nëse rezultatet e tharjes janë të kënaqshme gjatë kohës që përdorni vetëm tableta të kombinuara, mund ta çaktivizoni njoftimin për rimbushjen e shpëlarësit. Megjithatë, për performancën më të mirë në tharje, gjithmonë përdorni shpëlarës.


Nëse përdoret detergjent standard ose tableta të kombinuara pa shpëlarës, aktivizoni njoftimin për ta mbajtur aktiv treguesin e rimbushjes me shpëlarës.


Çaktivizimi i opsionit të njoftimit se nuk ka solucion shpëlarës



Sigurohuni që pajisja të jetë në modalitetin e zgjedhjes së programit.

Sigurohuni që shënjesi i programit mbi buton të jetë në pozicionin ndezur/fikur.

1. Për të hyrë në modalitetin e përdoruesit, shtypni e mbani . Njëherësh rrotulloni butonin në drejtim të kundërt të akrepave të orës derisa shënjesi i programit të tregojë programin e parë. Lëshoni  kur treguesit  dhe ndezur/fikur të fillojnë të pulsojnë.
2. Rrotulloni butonin në drejtim të kundërt të akrepave të orës derisa shënjesi i programit të tregojë programin e dytë.

Treguesi  shfaq parametrin aktual:

-  ndezur = njoftimi se nuk ka solucion shpëlarës është i aktivizuar.

-  fikur = njoftimi se nuk ka solucion shpëlarës është i çaktivizuar.
3. Shtypni  për të ndryshuar parametrin.
 4. Për të konfirmuar parametrin, vazhdoni të rrotulloni butonin e programeve derisa shënjesi i programit të jetë sërish në pozicionin ndezur/fikur.




6.4 Niveli i shkëlqyesit


Mund ta caktoni sasinë e lëshuar të shkëlqyesit ndërmjet nivelit 1 (sasia minimale) dhe nivelit 8 (sasia maksimale). Niveli 0 çaktivizon kutinë e shkëlqyesit dhe shkëlqyesi nuk del. Cilësimi i fabrikës: niveli 5.


Si të caktoni nivelin e solucionit shpëlarës

Sigurohuni që pajisja të jetë në modalitetin e zgjedhjes së programit.

Sigurohuni që shënjesi i programit mbi buton të jetë në pozicionin ndezur/fikur.


1. Për të hyrë në modalitetin e përdoruesit, shtypni e mbani . Njëherësh rrotulloni çelësin në drejtim të kundërt të akrepave të orës derisa shënjesi i programit të tregojë programin e parë. Lëshoni  kur treguesit  dhe ndezur/fikur të fillojnë të pulsojnë.
2. Rrotulloni butonin në drejtim të kundërt të akrepave të orës derisa shënjesi i programit të tregojë programin e dytë.


Treguesi  tregon parametrin aktual, p.sh. 5 pulsime + pauzë + 5 pulsime = niveli 5.

3. Shtypni  për të ndryshuar parametrin.
4. Për të konfirmuar parametrin, vazhdoni të rrotulloni butonin e programeve derisa shënjesi i programit të jetë sërish në pozicionin ndezur/fikur.

6.5 AirDry

AirDry përmirëson rezultatet e tharjes duke konsumuar më pak energji. Dera e pajisjes hapet automatikisht gjatë fazës së tharjes dhe mbetet paksa e hapur.



AirDry aktivizohet automatikisht me të gjitha programet përveç  (nëse vlen për rastin).

Kohëzgjatja e fazës së tharjes dhe koha e hapjes së derës ndryshojnë në varësi të programit të zgjedhur dhe opsioneve.



KUJDES!

Mos u përipiqni të mbyllni derën e pajisjes brenda 2 minutave pas hapjes automatike. Kjo mund të shkaktojë dëmtime në pajisje.

Nëse pas kësaj dera mbyllet për të paktën 3 minuta, programi në punë përfundon.






KUJDES!

Nëse fëmijët kanë akses te pajisja, këshillohet që ta çaktivizoni AirDry. Hapja automatike e derës mund të përbëjë rrezik.




Çaktivizimi i AirDry

Sigurohuni që pajisja të jetë në modalitetin e zgjedhjes së programit.

Sigurohuni që shënjesi i programit që gjendet mbi butonin të jetë në pozicionin ndezur/fikur.

1. Për të hyrë në modalitetin e përdoruesit, shtypni e mbani . Njëherësh rrotulloni butonin në drejtim të kundërt të akrepave të orës derisa shënjesi i programit të tregojë programin e parë. Lëshoni  kur treguesit  dhe ndezur/fikur të fillojnë të pulsojnë.
2. Rrotulloni butonin në drejtim të kundërt të akrepave të orës derisa shënjesi i programit të tregojë programin e dytë.

Treguesi  shfaq parametrin aktual:

-  ndezur = AirDry aktiv.
 -  fikur = AirDry joaktiv.
3. Shtypni  për të ndryshuar parametrin.
 4. Për të konfirmuar parametrin, vazhdoni të rrotulloni butonin e programeve derisa shënjesi i programit të jetë sërish në pozicionin ndezur/fikur.

7. PËRPARA PËRDORIMIT TË PARË

1. Sigurohuni që niveli aktual i zbutësit të ujit të përkojë me fortësinë e ujit në zonën që furnizohet. Nëse jo, përshtatni nivelin e zbutësit të ujit.
2. Mbushni kutinë e kripës.
3. Mbushni shpërndarësin e shkëlqyesit.
4. Hapeni rubinetin e ujit.
5. Nisni një program për të hequr çdo mbetje të përpunuar që mund të jetë ende brenda pajisjes. Mos përdorni detergjent dhe mos vendosni enë në kosha.

Pasi nisni një program, pajisja rimbush solucionin në zbutësin e ujit për deri në 5 minuta. Faza e larjes fillon vetëm pasi kjo procedurë të ketë përfunduar. Procedura përsëritet në mënyrë periodike.

7.1 Kutia e kripës



KUJDES!


Përdorni kripë të ashpër që është vetëm për lavastovilje. Kripa e imët rrit rrezikun e ndryshkut.

Kripa përdoret për të ringarkuar solucionin në zbutësin e ujit dhe për të garantuar rezultate të mira larjeje në përdorimin e përditshëm.


7.2 Mbushja e kutisë së kripës

1. Rrotullojeni kapakun e kutisë së kripës në drejtim të kundërt të akrepave të orës dhe hiqeni.
2. Vendosni 1 litër ujë në kutinë e kripës (vetëm herën e parë).

3. Mbusheni kutinë e kripës me 1 kg kripë (derisa të mbushet plot).



4. Tundeni hinkën me kujdes nga doreza që të futen brenda edhe kokrrizat e fundit.
5. Hiqni kripën përreth vrimës së kutisë së kripës.




6. Rrotulloni kapakun e kutisë së kripës në drejtim të akrepave të orës për ta mbyllur kutinë e kripës.



KUJDES!

Uji dhe kripa mund të derdhen nga kutia e kripës kur e mbushni. Pasi ta mbushni kutinë e kripës, nisni menjëherë një program larjeje për të shmangur gërryerjen.

7.3 Si të mbushni kutinë e solucionit të shpëlarjes



KUJDES!

Ndarja (C) është vetëm për solucionin e shpëlarjes. Mos e mbushni me detergjent.




KUJDES!

Përdorni vetëm solucion shpëlarje të posaçëm për lavastovilje.

1. Shtypni elementin e lëshimit (A) për të hapur kapakun (B).
2. Hidhni solucionin e Shpëlarjes në kutinë e tij (C) derisa lëngu të arrijë shenjën "FILL".
3. Hiqni solucionin e shpëlarjes që është derdhur me një leckë thithëse për të parandaluar formimin e shkumës së tepërt.
4. Mbyllni kapakun. Sigurohuni që kapaku të kyçet në pozicion.

8. PËRDORIMI I PËRDITSHËM

1. Hapeni rubinetin e ujit.
 2. Rrotulloni çelësin derisa shënuesi i programit të jetë në një vijë me programin që dëshironi të caktoni. Caktimi programin e duhur për llojin e ngarkesës dhe nivelin e ndotjes.
 - Nëse treguesit e kripës janë të ndezur, mbushni kutinë e kripës.
 - Nëse treguesi i shpëlarjes është i ndezur, mbushni shpërndarësin e shpëlarjes.
 3. Mbushni koshat.
 4. Shtoni detergjentin.
 5. Nisni programin.
- ### 8.1 Përdorimi i detergjentit




KUJDES!

Përdorni vetëm detergjent të posaçëm për lavastovilje.

1. Shtypni butonin e lëshimit (B) për të hapur kapakun (C).
2. Vendosni detergjentin në ndarjen (A). Mund të përdorni detergjent në tableta, pluhur ose xhel.
3. Nëse programi ka fazë paralarjeje, vendosni një sasi të vogël detergjenti në pjesën e brendshme të derës së pajisjes.
4. Mbyllni kapakun. Sigurohuni që kapaku të ngecë në vend.


8.2 Vendosja dhe startimi i një programi

Nisja e një programi


1. Hapni rubinetin e ujit.
2. Mbyllni derën e pajisjes.
3. Kthejeni çelësin derisa shënuesi i programit të jetë te programi që dëshironi të caktoni.
 - Treguesi aktiv/joaktiv është aktiv.
 - Treguesi i ndezjes fillon të pulsojë.
4. Shtypni .

- Programi fillon.
- Treguesi i fazës së larjes është aktiv.
- Treguesit ndezur/fikur dhe ai i nisjes janë aktivë.

Nisja e një programi me anë të ndezjes të vonuar

1. Caktoni një program.
2. Shtypni  për të shtyrë fillimin e programit me 3 orë.


Drita që i përket butonit është e ndezur.

3. Shtypni  për të filluar numërimin mbrapsht.



Drita që i përket butonit është e ndezur. Gjatë numërimit mbrapsht, nuk mund të ndryshohet programi.

Programi fillon kur përfundon numërimi mbrapsht.

Anulimi i programit

Shtypni e mbani  derisa të pulsojë drita përkatëse e butonit. Sigurohuni që të ketë detergjent në kutinë e detergjentit përpara se të filloni një program të ri.

Anulimi i nisjes së vonuar gjatë numërimit mbrapsht

1. Shtypni e mbani  derisa të pulsojë drita përkatëse e butonit.
2. Shtypni  për të filluar programin.

Hapja e derës ndërkohë që pajisja është në punë

Hapja e derës ndërkohë që programi është në punë, ndalon pajisjen. Kjo

mund të ndikojë në konsumin e energjisë dhe kohëzgjatjen e programit. Pasi e mbyllni derën, pajisja vazhdon nga pika ku u ndërpre.



Nëse dera mbahet hapur për më shumë se 30 sekonda gjatë fazës së tharjes, programi që është në punë do të përfundojë. Kjo nuk ndodh nëse dera hapet me funksionin AirDry.



Mos u përpiqni të mbyllni derën e pajisjes brenda 2 minutave pasi AirDry e hap atë automatikisht, sepse kjo mund të shkaktojë dëmtime në pajisje. Nëse pas kësaj dera mbyllet për të paktën 3 minuta, programi në punë përfundon.

Funksioni Auto Off

Ky funksion ul konsumin e energjisë duke e çaktivizuar automatikisht pajisjen kur ajo nuk është në punë.

Funksioni nis të funksionojë:

- Kur programi ka përfunduar.
- Pas 5 minutave, nëse programi nuk ka filluar.

Fundi i programit

Kur përfundon programi, funksioni Auto Off e fik pajisjen.

Mbyllni rubinetin e ujit.

9. UDHËZIME DHE KËSHILLA

9.1 Të përgjithshme

Ndiqui këshillat e mëposhtme për të garantuar rezultate optimale pastrimi dhe tharjeje në përdorimin ditor dhe për të ndihmuar në mbrojtjen e mjedisit.

- Larja e enëve në lavastovilje sipas udhëzimeve të manualit të përdorimit

zakonisht konsumon më pak ujë dhe energji se larja me dorë.

- Mbusheni lavastoviljen në kapacitet të plotë për të kursyer ujë dhe energji. Për rezultate më të mira në pastrim, sistemojini artikujt në kosha sipas udhëzimeve të manualit të përdorimit dhe mos i mbingarkoni koshat.

- Mos i shpëlani enët paraprakisht me dorë. Kjo rrit konsumin e ujit dhe energjisë. Kur t'ju nevojitet, vendosni një program me fazë paralarjeje.
- Hiqni mbetjet e mëdha ushqimore nga enët dhe zbrazni gotat dhe filxhanët përpara se t'i fusni në pajisje.
- Njomini ose shpëlajini lehtë enët e gatimit me ushqim të ngjitur nga gatimi përpara se t'i lani në pajisje.
- Sigurohuni që artikujt në koshë të mos prekin ose të mos mbulojnë njeri-tjetrin. Vetëm atëherë uji mund të arrijë dhe të lajë plotësisht enët.
- Mund të përdorni detergjent për larjen e enëve, shpëlarës dhe kripë veçmas ose mund të përdorni tabletat e shumëfishta (p.sh. "Të gjitha në 1"). Ndiqni udhëzimet e shfaqura në paketim.
- Zgjidhni një program sipas llojit të ngarkesës dhe nivelit të ndotjes.

ECO ofron përdorimin më efikas të ujit dhe energjisë.

- Për të parandaluar akumulimin e çmërsit brenda pajisjes:
 - Rimbusheni kutinë e kripës sa herë që të jetë e nevojshme.
 - Përdorni dozën e rekomanduar të detergjentit dhe shkëlqyesit.
 - Sigurohuni që niveli aktual i zbutësit të ujit të përkojë me fortësinë e ujit në zonën që furnizohet.
 - Ndiqni udhëzimet në kapitullin **"Kujdesi dhe pastrimi"**.

9.2 Përdorimi i kripës, shkëlqyesit dhe detergjentit

- Përdorni vetëm kripë, shkëlqyes dhe detergjent të projektuar për lavastovilje. Produktet e tjera mund të shkaktojnë dëmtimin e pajisjes.
- Në zonat me ujë të fortë dhe shumë të fortë ne rekomandojmë përdorimin e një detergjenti të thjeshtë për lavastovilje (pluhur, xhel, tableta pa agjentë shtesë), shkëlqyesit dhe kripës veçmas për rezultate optimale pastrimi dhe tharjeje.
- Tabletat e detergjentit nuk shkrihen plotësisht në programet e shkurtra. Për të parandaluar mbetjet e detergjentit të takëmet, ne ju

rekomandojmë që t'i përdorni tabletat me programet e gjata.

- Gjithmonë përdorni sasinë e duhur të detergjentit. Dozimi i pamjaftueshëm i detergjentit mund të rezultojë në rezultate pastrimi të këqija dhe veshje ose njolla të enët nga uji i fortë. Përdorimi i detergjentit të tepërt me ujë të butë ose të zbutur rezulton në mbetje detergjenti mbi enë. Rregulloni sasinë e detergjentit në fortësinë e ujit. Referojuni udhëzimeve që jepen në paketimin e detergjentit.
- Gjithmonë përdorni sasinë e duhur të shkëlqyesit. Dozimi i pamjaftueshëm i shkëlqyesit ul rezultatet e tharjes. Përdorimi i tepërt i shkëlqyesit rezulton në shtresa ngjyrë blu mbi enë.
- Sigurohuni që niveli i zbutësit të ujit të jetë në rregull. Nëse niveli është tepër i lartë, sasia e tepërt e kripës në ujë mund të krijojë ndryshk nëpër takëme.

9.3 Si të veproni nëse dëshironi të ndaloni përdorimin e tabletave të shumëfishta

Përpara se të përdorni veç e veç detergjentin, kripën dhe shpëlarësin, kryeni procedurën e mëposhtme.

1. Vendosni nivelin më të lartë të zbutësit të ujit.
2. Sigurohuni që kutia e kripës dhe kutia e shpëlarësit të jenë plot.
3. Nisni programin më të shkurtër me fazë shpëlarjeje. Mos shtoni detergjent dhe mos i ngarkoni koshat.
4. Kur programi të përfundojë, përshtateni zbutësin e ujit sipas fortësisë së ujit në zonën tuaj.
5. Rregulloni sasinë e lëshimit të shpëlarësit.

9.4 Ngarkimi i koshave

- Përdoreni gjithmonë të gjithë hapësirën e koshave.
- Përdoreni pajisjen për të larë vetëm artikuj që mund të lahen në lavastovilje.
- Mos lani në pajisje artikuj prej druri, briiri, alumini, kallaji dhe bakri sepse

ato mund të krisen, deformohen ose çngjyrosen.

- Mos lani në pajisje artikujt që thithin ujë (sfungjerë, lecka pastrimi).
- Futini artikujt e thellë (filxhanët, gotat dhe tenxheret) me pjesën e hapur të drejtuar poshtë.
- Sigurohuni që gotat të mos prekin njëra-tjetrën.
- Vendosni artikujt e lehtë në koshin e sipërm. Sigurohuni që artikujt të mos lëvizin lirshëm.
- Vendosni takëmet dhe artikujt e vegjël në koshin e takëmeve.
- Sigurohuni që krahët spërkatës të jenë në gjendje të lëvizin lirisht përpara se të nisni një program.

9.5 Përpara fillimit të një programi

Përpara se të nisni programin e zgjedhur, sigurohuni që:

- Filtrat janë të pastër dhe të vendosur saktë.

- Kapaku i kutisë së kripës është i shtrënguar.
- Krahët spërkatës nuk janë të bllokuar.
- Ka kripë dhe shpëlarës të mjaftueshëm (përveç rastit kur përdorni tableta të shumëfishta).
- Pozicionimi i artikujve në kosha është i saktë.
- Programi mund të përdoret për llojin e ngarkesës dhe për shkallën e ndotjes.
- Është përdorur sasia e duhur e detergjentit.

9.6 Zbrazja e koshave

1. Lëri enët të ftohen para se t'i hiqni ato nga pajisja. Enët e nxehta mund të dëmtohen lehtë.
2. Boshatisni koshin e poshtëm në fillim e më pas atë të sipërmin.



Pasi përfundon programi, uji mund të qëndrojë ende në sipërfaqen e brendshme të pajisjes.

10. KUJDESI DHE PASTRIMI



PARALAJMËRIM!


Përpara se të kryeni mirëmbajtjen e pajisjes, çaktivizojeni atë dhe hiqeni nga priza.




Filtrat e ndotur dhe krahët spërkatës të bllokuar zvogëlojnë rezultatet e larjes. Kontrollojini rregullisht dhe, nëse është e nevojshme, pastrojini ato.


10.1 Pastrimi i filtrave

Sistemi i filtrave përbëhet nga 3 pjesë.




1. Rrotullojeni filtrin (B) në drejtim kundërorar dhe hiqeni.







2. Hiqeni filtrin (C) jashtë filtrit (B).
3. Hiqeni filtrin e sheshtë (A).



4. Lajini filtrat.




5. Sigurohuni që nuk ka mbetje ushqimesh ose dheu brenda ose përreth pjesëve anësore të dekantuesit.
6. Kthejeni filtrin e rrafshët në vend (A). Sigurohuni që të vendoset në mënyrë të saktë sipas 2 udhëzuesve.



7. Rimontoni filtrat (B) dhe (C).

8. Vendoseni përsëri filtrin (B) në filtrin e sheshtë (A). Rrotullojeni në drejtim orar derisa të ngecë.



KUJDES!


Pozicionimi i pasaktë i filtrave mund të sjellë rezultate të këqija larjeje dhe dëmim të pajisjes.

10.2 Pastrimi i krahut të poshtëm spërkatës


Rekomandojmë të pastroni rregullisht krahun e poshtëm spërkatës për të shmangur bllokimin e vrimave nga ndotja.

Vrimat e bllokuara mund të sjellin rezultate të pakënaqshme larjeje.


1. Për të hequr krahun e poshtëm spërkatës, tërhiqeni atë lart.



2. Lajeni krahun spërkatës në ujë të rrjedhshëm. Përdorni një mjet të hollë me majë, p.sh. kruajtëse dhëmbësh, për të hequr mbetjet e ndotjes nga vrimat.




3. Për të instaluar sërish krahun spërkatës, shtypeni poshtë.




10.3 Pastrimi i krahëve të sipërm spërkatës

Rekomandojmë të pastroni rregullisht krahët e sipërm spërkatës për të shmangur bllokimin e vrimave nga ndotja. Vrimat e bllokuara mund të sjellin rezultate të pakënaqshme larjeje.


Krahët e sipërm spërkatës vendosen poshtë koshit të sipërm. Krahët spërkatës (B) janë instaluar në tub (A) me elementin e montimit (C).




1. Tërhiqni jashtë koshin e sipërm.
2. Për të shkëputur krahun spërkatës, rrotullojeni elementin e montimit në drejtim të akrepave të orës.



3. Lajeni krahun spërkatës në ujë të rrjedhshëm. Përdorni një mjet të hollë me majë, p.sh. kruajtëse dhëmbësh, për të hequr mbetjet e ndotjes nga vrimat.



4. Për të instaluar sërish krahun spërkatës, futni elementin e montimit në krahun spërkatës dhe fiksoseni në tub duke e rrotulluar në drejtim të kundërt të akrepave të orës. Sigurohuni që elementi i montimit të bllokohet në vend.



10.4 Pastrimi i jashtëm

- Pastrojeni pajisjen me një leckë të butë të lagësht.
- Përdorni vetëm detergjente neutrale.

- Mos përdorni produkte gërryese, materiale pastruese të ashpra ose tretës.

10.5 Pastrimi i brendshëm

- Pastroni me kujdes pajisjen me një leckë të butë e të njomë, duke përfshirë llastikun prej gome të derës.
- Nëse përdorni rregullisht programe me kohëzgjatje të shkurtër, këto mund të lënë depozita yndyre dhe çmërsi brenda pajisjes. Për të parandaluar këtë, rekomandojmë të përdorni programe me kohëzgjatje të gjatë të paktën 2 herë në muaj.
- Për të ruajtur performancën e pajisjes suaj në nivele maksimale, rekomandojmë të përdorni çdo muaj një produkt specifik pastrimi për lavastoviljet. Ndiqni me kujdes udhëzimet në paketimin e produktit.

10.6 Heqja e objekteve të huaja

Kontrolloni filtrat dhe grupin e shkarkimit pas çdo përdorimi të lavastoviljes. Objektet e huaja (p.sh. copat e xhamit, plastikës, kockat ose kruajtëset e dhëmbëve etj.) ulin performancën e pastrimit dhe mund të shkaktojnë dëmtim të pompës së shkarkimit.

1. Çmontoni sistemin e filtrave sipas udhëzimeve në këtë kapitull.
2. Hiqni me dorë çdo objekt të huaj.



KUJDES!

Nëse nuk jeni në gjendje t'i hiqni objektet, kontaktoni me një qendër të autorizuar shërbimi.

3. Rimontoni filtrat sipas udhëzimeve në këtë kapitull.

11. ZGJIDHJA E PROBLEMEVE



PARALAJMËRIM!







Riparimi i gabuar i pajisjes mund të sjellë rrezik për përdoruesin. Çdo riparim duhet kryer vetëm nga personel i kualifikuar.



Referojuni tabelës së mëposhtme për informacion rreth problemeve të mundshme.

Me disa probleme, treguesi i dedikuar pulson me ndërprerje për të treguar një keqfunksionim dhe kodin e alarmit.

Shumica e problemeve që mund të ndodhin mund të zgjidhen pa nevojën e një qendre të autorizuar shërbimi.

Problemi dhe kodi i alarmit	Shkaku i mundshëm/zgjidhja
Nuk mund ta aktivizoni pajisjen.	<ul style="list-style-type: none"> • Sigurohuni që spina kryesore të jetë e lidhur me prizën e rrejtë. • Sigurohuni që të mos keni siguresa të dëmtuara në kutinë e siguresave.
Programi nuk fillon.	<ul style="list-style-type: none"> • Sigurohuni që dera e pajisjes të jetë mbyllur mirë. • Shtypni butonin start • Nëse është caktuar ndezja e vonuar e pajisjes, anuloni parametrin ose prisni sa të përfundojë numërimi mbrapsht. • Pajisja rimbush rezinën brenda zbutësit të ujit. Kohëzgjatja e procedurës është rreth 5 minuta.

Problemi dhe kodi i alarmit	Shkaku i mundshëm/zgjidhja
<p>Pajisja nuk mbushet me ujë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Treguesi  pulson 1 herë me ndërprerje. • Drita e lidhur me butonin e nisjes pulson në mënyrë të vazhdueshme. 	<ul style="list-style-type: none"> • Sigurohuni që rubineti i ujit të jetë i hapur. • Sigurohuni që presioni i furnizimit me ujë të mos jetë shumë i ulët. Për këtë informacion, kontaktoni autoritetin tuaj lokal të ujit. • Sigurohuni që rubineti i ujit të mos jetë bllokuar. • Sigurohuni që filtri në tubin dalës të mos jetë i bllokuar. • Sigurohuni që zorra e kullimit të mos jetë e përdredhur ose e përthyer.
<p>Pajisja nuk e shkarkon ujin.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Treguesi  pulson 2 herë me ndërprerje. • Drita e lidhur me butonin e nisjes pulson në mënyrë të vazhdueshme. 	<ul style="list-style-type: none"> • Sigurohuni që tapa e lavamanit të mos jetë e bllokuar. • Sigurohuni që sistemi i filtrit të brendshëm të mos jetë i bllokuar. • Sigurohuni që zorra e kullimit të mos jetë e përdredhur ose e përthyer.
<p>Është aktivizuar pajisja kundër përmbytjes.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Treguesi  pulson 3 herë me ndërprerje. • Drita e lidhur me butonin e nisjes pulson në mënyrë të vazhdueshme. 	<ul style="list-style-type: none"> • Mbyllni rubinetin e ujit. • Sigurohuni që pajisja të jetë instaluar saktë. • Sigurohuni që koshat të jenë ngarkuar siç udhëzon manuali i përdorimit.
<p>Keqfunksionim i sensorit të zbulimit të niveli të ujit.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Treguesi  pulson 4 herë me ndërprerje. • Drita e lidhur me butonin e nisjes pulson në mënyrë të vazhdueshme. 	<ul style="list-style-type: none"> • Sigurohuni që filtrat të jenë të pastër. • Fikeni dhe rindizeni pajisjen.
<p>Keqfunksionim i pompës së larjes ose pompës së shkarkimit.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Treguesi  pulson 5 herë me ndërprerje. • Drita e lidhur me butonin e nisjes pulson në mënyrë të vazhdueshme. 	<ul style="list-style-type: none"> • Fikeni dhe rindizeni pajisjen.
<p>Temperatura e ujit brenda pajisjes është tepër e lartë ose ka ndodhur keqfunksionim i sensorit të temperaturës.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Treguesi  pulson 6 herë me ndërprerje. • Drita e lidhur me butonin e nisjes pulson në mënyrë të vazhdueshme. 	<ul style="list-style-type: none"> • Sigurohuni që temperatura e ujit në hyrje të mos tejkalojë 60°C. • Fikeni dhe rindizeni pajisjen.

Problemi dhe kodi i alarmit	Shkaku i mundshëm/zgjidhja
Keqfunksionim teknik i pajisjes. <ul style="list-style-type: none"> • Treguesi  pulson 12 herë me ndërprerje. • Drita e lidhur me butonin e nisjes pulson në mënyrë të vazhdueshme. 	<ul style="list-style-type: none"> • Fikeni dhe rindizeni pajisjen.
Niveli i ujit brenda pajisjes është tepër i lartë. <ul style="list-style-type: none"> • Treguesi  pulson 15 herë me ndërprerje. • Drita e lidhur me butonin e nisjes pulson në mënyrë të vazhdueshme. 	<ul style="list-style-type: none"> • Fikeni dhe rindizeni pajisjen. • Sigurohuni që filtrat të jenë të pastër. • Sigurohuni që tubi i daljes të jetë instaluar në lartësinë e duhur nga dyshemeja. Shikoni udhëzimet e instalimit.
Pajisja ndalon dhe fillon shumë herë gjatë procesit.	<ul style="list-style-type: none"> • Është normale. Kjo sjell rezultate optimale në larje dhe kursim energjie.
Programi zgjat shumë.	<ul style="list-style-type: none"> • Nëse është vendosur ndezja e vonuar, anuloni parametrin e vonësës ose prisni sa të përfundojë numërimi mbrapsht. • Shihni tabelën e vlerave të konsumit në kapitullin "Zgjedhja e programit".
Rrjedhje e vogël nga dera e pajisjes.	<ul style="list-style-type: none"> • Pajisja nuk është e niveluar. Lironi ose shtërngoni këmbët e rregullueshme (nëse ka). • Dera e pajisjes nuk është e centruar me kazanin. Rregulloni këmbët e pasme (nëse ka).
Dera e pajisjes mbyllet me vështirësi.	<ul style="list-style-type: none"> • Pajisja nuk është e niveluar. Lironi ose shtërngoni këmbët e rregullueshme (nëse ka). • Pjesë të takëmeve dalin jashtë nga koshat.
Dera e pajisjes hapet gjatë ciklit të larjes.	<ul style="list-style-type: none"> • Funkzioni AirDry është aktiv. Mund ta çaktivizoni funksionin. Referojuni "Parametrave".
Zhurma kërcitëse/goditëse nga brenda pajisjes.	<ul style="list-style-type: none"> • Takëmet nuk janë rregulluar mirë në kosha. Referojuni fletëpalosjes së mbushjes së koshave. • Sigurohuni që krahët spërkatës të rrotullohen lirshëm.
Bie automati nga pajisja.	<ul style="list-style-type: none"> • Amperazhi është i pamjaftueshëm për të furnizuar njëkohësisht të gjitha pajisjet në përdorim. Kontrolloni amperazhin e prizës dhe kapacitetin e matësit ose fikni një prej pajisjeve që jeni duke përdorur. • Defekt i brendshëm elektrik i pajisjes. Kontaktoni një Qendër të Autorizuar të Shërbimit.



Referojuni kapitujve “Përpara përdorimit”, “Përdorimi i përditshëm” ose “Udhëzime dhe këshilla” për shkaqet e tjera të mundshme.

**PARALAJMËRIM!**

Nuk rekomandojmë që ta përdorni pajisjen derisa problemi të jetë zgjidhur plotësisht. Shkëputeni pajisjen nga energjia dhe mos e lidhni përsëri derisa të jeni të sigurt se funksionon mirë.

Pasi të keni kontrolluar pajisjen, shtypni butonin e nisjes. Nëse problemi ndodh përsëri, kontaktoni një Qendër të Autorizuar të Shërbimit.

Për kodet e alarmeve që nuk përshkruhen në tabelë, kontaktoni një Qendër të Autorizuar të Shërbimit.

11.1 Rezultatet e larjes dhe tharjes nuk janë të kënaqshme

Problemi	Shkaku i mundshëm dhe zgjidhja
Rezultate të pakënaqshme larjeje.	<ul style="list-style-type: none"> Referojuni "Përdorimi i përditshëm", "Udhëzime dhe këshilla" dhe fletëpalosjes për mbushjen e koshave. Përdorni programe me larje më intensive. Pastroni injektorët e krahëve spërkatës dhe filtrin. Shikoni "Kujdesi dhe pastrimi".
Rezultate të pakënaqshme tharjeje.	<ul style="list-style-type: none"> Takëmet janë lënë shumë kohë brenda pajisjes së mbyllur. Nuk ka shpëlarës ose dozimi i shpëlarësit nuk është i mjaftueshëm. Vendoseni kutinë e shpëlarësit në nivel më të lartë. Artikujt plastikë mund të duhet të thahen me peshqir. Për performancë më të mirë në tharje, aktivizoni AirDry. Rekomandojmë të përdorni gjithmonë shpëlarës edhe në kombinim me tableta të shumëfishta.
Ka njolla të bardha ose shtresa blu mbi gota dhe enë.	<ul style="list-style-type: none"> Sasia e lëshuar e solucionit shpëlarës është tepër e madhe. Rregulloni nivelin e solucionit shpëlarës në një nivel më të ulët. Sasia e detergjentit është tepër e madhe.
Ka njolla dhe shenja piklash uji të thara mbi gota dhe enë.	<ul style="list-style-type: none"> Sasia e lëshuar e solucionit shpëlarës nuk është e mjaftueshme. Rregulloni nivelin e solucionit shpëlarës në një nivel më të lartë. Shkaku mund të jetë cilësia e solucionit shpëlarës.

Problemi	Shkaku i mundshëm dhe zgjidhja
Enët janë të njoma.	<ul style="list-style-type: none"> • Për performancë më të mirë në tharje, aktivizoni AirDry. • Programi nuk ka fazë tharje ose ka fazë tharje me temperaturë të ulët. • Mbushni folenë e solucionit shpëlarës nëse është bosh. • Shkaku mund të jetë cilësia e solucionit shpëlarës. • Shkak mund të jetë cilësia e multi-tabletave. Provoni një markë tjetër ose aktivizoni shpërndarësin e shpëlarësit dhe përdoreni shpëlarësin bashkë me tabletat e shumëfishta.
Pjesa e brendshme e pajisjes është e lagur.	<ul style="list-style-type: none"> • Ky nuk është defekt i pajisjes. Ai shkaktohet nga lagështira në ajër e cila kondensohet në paretet e saj.
Shkumë e pazakontë gjatë larjes.	<ul style="list-style-type: none"> • Përdorni detergjent të posaçëm për lavastovilje. • Përdorni detergjent të një prodhuesi tjetër. • Mos i parashpëlani enët me ujë të rrjedhshëm përpara se t'i vendosni brenda në pajisje.
Ka gjurmë ndryshku në takëme.	<ul style="list-style-type: none"> • Në ujin e përdorur për larje ka shumë kripë. Referojuni kapitullit “Zbutësi i ujit”. • Janë vendosur bashkë takëme prej argjendi dhe inoksi. Shmangni vendosjen së bashku të artikujve prej argjendi dhe inoksi.
Ka mbetje detergjenti në kuti në përfundim të programit.	<ul style="list-style-type: none"> • Tableta e detergjentit ka ngecur në shpërndarës dhe për këtë arsye nuk është larë krejtësisht nga uji. • Uji nuk mund të largojë detergjentin nga kutia. Sigurohuni që krahu spërkatës të mos jetë i bllokuar. • Sigurohuni që artikujt në kosha të mos pengojnë hapjen e kapakut të kutisë së detergjentit.
Pajisja mban erë të keqe nga brenda.	<ul style="list-style-type: none"> • Referojuni kapitullit “Pastrimi i brendshëm”.
Depozitime çmërsi në takëme, në kazan dhe në anën e brendshme të derës.	<ul style="list-style-type: none"> • Niveli i kripës është i ulët, kontrolloni treguesin e rimbushjes. • Kapaku i kutisë së kripës rri lirshëm. • Uji i rubinetit është i fortë. Referojuni kapitullit “Zbutësi i ujit”. • Edhe kur përdorni tableta të shumëfishta, përdorni kripë dhe vendosni rigjenerimin e zbutësit të ujit. Referojuni kapitullit “Zbutësi i ujit”. • Nëse ka ende depozita çmërsi, pastroni pajisjen me pastrues të përshtatshëm enkas për këtë qëllim. • Provoni detergjente të ndryshme. • Kontakttoni prodhuesin e detergjentit.

Problemi	Shkaku i mundshëm dhe zgjidhja
Takëme të turbullta, të çngjyrosura ose të ciflosura.	<ul style="list-style-type: none"> • Sigurohuni që në pajisje të lahen vetëm artikuj për larje në lavastovilje. • Ngarkoni dhe shkarkoni koshin me kujdes. • Referojuni fletëpalosjes së mbushjes së koshave. • Vendosini artikujt delikatë në koshin e sipërm.



Referojuni "**Përpara përdorimit të parë**", "**Përdorimi i përditshëm**" ose "**Udhëzime dhe këshilla**" për shkaqet e tjera të mundshme.

12. TË DHËNA TEKNIKE

Përmasat	Gjerësia / lartësia / thellësia (mm)	446 / 850 / 615
Lidhja elektrike ¹⁾	Tensioni (V)	220 - 240
	Frekuenca (Hz)	50
Presioni i furnizimit me ujë	Min. / maks. bar (MPa)	0.5 (0.05) / 8 (0.8)
Furnizimi me ujë	Ujë i ftohtë ose ujë i ngrohtë ²⁾	maks. 60°C
Kapaciteti	Cilësimet e vendeve	9
Konsumi i energjisë	Modaliteti lënë ndezur (W)	5.0
	Modaliteti fikur (W)	0.50

¹⁾ Referojuni pllakës së klasifikimit për vlerat e tjera.

²⁾ Nëse uji i ngrohtë vjen nga burim alternativ energjie (p.sh. panele diellore), përdorni furnizimin me ujë të nxehtë për të ulur konsumin e energjisë.

12.1 Lidhja te databaza e EU EPREL


Kodi QR në etiketën e energjisë të dhënë me pajisjen jep një lidhje uebi te regjistrimi i kësaj pajisjeje në databazën e EU EPREL. Ruajeni etiketën e energjisë për referencë së bashku me manualin e përdorimit dhe të gjitha dokumentet e tjera që ofrohen me këtë pajisje.


Informacionin në lidhje me performancën e produktit në databazën e EU EPREL

mund ta gjeni duke përdorur lidhjen <https://eprel.ec.europa.eu> dhe emrin e modelit dhe numrin e produktit që gjeni në pllakëzën e specifikimeve të pajisjes. Shikoni kapitullin "Përshkrimi i produktit".

Për më shumë informacion të detajuar rreth etiketës së energjisë, vizitoni www.theenergylabel.eu.

13. ÇËSHTJE QË LIDHEN ME AMBIENTIN

Ricikloni materialet me simbolin .
Vendoseni ambalazhin te kontejnerët e riciklimit nëse ka. Ndhmoni në mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njerëzve dhe në riciklimin e mbetjeve të pajisjeve elektrike dhe elektronike. Mos hidhni

pajisjet e shënuara me simbolin  e mbeturinave shtëpiake. Ktheni produktin në pikën lokale të riciklimit ose kontaktoni me zyrën komunale.

www.electrolux.com/shop



156949590-A-352020

